

NGADO QË KAM SHKUAR KAM DEKLARUAR JAM KRENUAR QË JAM TETOVAR

Genc (Avni Ruzhdiu) DERRALLA

Një promemorje dhe një përshendetje Konferencës shkencore:

“102 vjet shtet shqiptar me pastaj -Ceshtja shqiptare dhe Derallajt”

Mbahet një konferencë shkencore kombëtare në qytetin e Tetovës. Nëqoftëse mund t'a quaj si parafjalë fillimin e kësaj promemorje , më duhet së pari të falenderoj zotin. Arsim Sinani, president i Qendrës për studime ballkanike, për iniciativën e shkëlqyer për mbajtjen e kësaj Konference si edhe për organizimin e mirë dhe të bukur të këtij tubimi me përfaqesues nga të gjitha trevat shqipfolëse dhe nga disa dashamires të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Është kënaqësi të shikosh seriozitetin dhe përgatitjen shkencore të personaliteteve të ndryshme me dhe pa grada shkencore, por të gjitha me sensin e dashurisë për Shqipërinë. Mund të them se ky është vetëm një fillim i mirë e i shumë pritur , jo vetëm për shqiptarët por edhe për studiuesit e historisë nga vende të ndryshme të botës. Duhet të pranojmë megjithatë, se jemi me vonesë në këtë pikë , për evidentimin historik së ngjarjeve , datave dhe heronjve tanë që kanë realizuar këtë histori me mundime dhe sakrifica shumë të mëdha duke e shkruar atë me gjakun e tyre e deri në vetemohim për këtë vend, që quhet Shqipëri.

Historia e vendit tonë është shumë e vjetër dhe shumë më e vjetër se historitë e shumë vendeve ,qofshin këto në Ballkan, Europë dhe në botë. Në shkrime të vjetra dhe të ndryshme , nga temat për të cilat janë shkruar e kujtojnë si emër por pa u thelluar në brendesite saja. Shqipëria me shekuj përpara është kujtuar nganjëherë për ngjarje ose emra të ndryshëm, por kjo fatkeqësisht nuk është bërë nxitje për t'u thelluar në hollësira. Shqiptarë ka në të gjitha vendet e botës, por kudo që janë kanë treguar gjithnjë se janë njerëz punëtorë , dashamirës, trima e sy

patrembur, specialiste të mirë në profesione të ndryshme , që nga ato të lehtat edhe të rëndat , por gjithmonë të bukura dhe të vlerësuara.

Por sic thashë më sipër , fatkeqësia jonë është se nuk i kemi shkruar. Mund t'a pranojmë me pak vështirësi se vetem këto dy shekujt e fundit kanë filluar evidentimet e ngjarjeve, historisë e të tjera dhe kjo na ndodh pikërisht ne, që kemi drejtuar dhe luftuar për ndreqien e shumë vendeve në botë, për ndërtimin e tyre , mbrojtjen e tyre, udhëheqien e tyre në jetë. Ne kemi qenë "Shqipëri e madhe " por jo se tani duhet t'a përmendim ne, dhe të mos na kërkohet falje, për atë që kanë bërë të tjerët në këtë vend. Mjaft u zgjata për këto gjëra, por flet ndërgjegjja ime nga pamundësia për të pasur edhe ne si familje vendin tonë. Por ne duhet ta kuptojmë që duhet të shkruajmë për ngjarjet që kemi kaluar në kurrizin tonë. Të kthehemi në kohërat e afërme, që janë akoma gjallë, në kujtesën e këtij populli dhe që nuk jane evidentuar në historinë tonë.

Në rastin konkret familja e jone e madhe , familja Deralla

Si familja Deralla, ka edhe shumë te tjera në Shqipërinë tonë të dashur, që pak njihen e për të cilat duhet shkruajtur. Familja Deralla ka hyrë në histori dhe kujtohet si familje e madhe, e pasur, aristokrate, e me dekada nga gjiri i saj kanë dale pashallarë, njerëz të ditur me shkollë ,e universitete të kryera në vende të ndryshme të Botës. Derallajt kanë lënë prapa shumë kujtime, Ruzhdiu, Kurti, Hasani, e të tjerë që sic thashë i kalojnë të dhjetë brezat, duke mbritur tek pashai i fundit i familjes, Mehmet Pashë Ruzhdi Deralla, duke mos harruar edhe të birin Halim Bej Deralla. Mehmet Pasha, duke lindur dhe rritur në një shtepi atdhedashëse, bëri pjesën e tij të historisë së familjes Deralla. Ai u rrit dhe u shkollua fillimisht në Tetovë e me mbas në Stamboll të Turqisë, ku arriti të marrë gradën e "gjeneralit" në moshën tridhjetë e pesë vjecare. Aftësitë e përfituara, ai, diti ti vë në jetë edhe në vendin e tij, në Tetovën e bukur dhe ne të gjithë Shqipërinë etnike. Mehmet Pasha Luftoi me shpatë e pushkë në dorë për bashkimin e trojeve shqiptare që shtetet e

mëdha na i morrën padrejtësisht dhe i dhuruan për interesa politike fuqive të tjera dhe interesave ballkanike.

Mehmet Pasha nuk u tremb dhe nuk përtoi që këtë edukatë dhe forcë morale ta trasmetojë tek brezat që pasuan tek djali i tij Halimi, e të tjerë. Ata mësuën dhe u ushqyen me atdhedashurinë, kujdesin për popullin dhe dashurinë për t'a parë Shqipërinë jo të ndarë në copa, por të bashkuar në idealin e një populli të vetëm. Mehmeti ishte trim dhe luftonte me shokë trima, dhe historia e njeh si njeri të ditur në mes të të diturve me ndjenjën kombëtare e të larte të atdhedashurisë. Nuk është e rastit shprehja e përdorur nga Mehmet Pasha që : “Vetem lufta me mend e me pushke ka me na qitë në dritë” Dhe amaneti i fundit i Mehmet Pasheska qene: “Amanet burra kater shtyllat e kombit (katër vilajetet) se janë nje bashkësi me nji gjuhë, një gjak, një flamur dhe një histori”.

Dhe në fund më lejoni tju them një të vërtetë që e ruaj gjatë gjithë jetës sime ndado që kam shkuar gjithnjë e kam thënë jam tetovar dhe vendlindja ime është Tetova, për këtë krenohem pavarësisht se padrejtësia ndaj familjes tonë është e madhe. Ne gjithnjë do vazhdojmë t'a ruajmë traditën se për atdhe duhet me u flijue.